



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:046795
Datë: 26.03.2025
Numri i dokumentit: 07045150

C.nr.422/24

GJYKATA THEMELORE NË P. – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil sipas gjyqtarit Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve:Sh.S. dhe Th. B. që të dyja nga P., të cilët i përfaqëson i autorizuari Mergim Himaj, avokat me seli ne Prishtinë, rr.”Nekibe Kelmendi”, objekti i L. C. “, pa nr., kundër të paditurës: Universiteti Publik „H.Z.” , rr. „UÇK” pa nr. në P., lidhur me çështjen juridike: kompensimin e diferencës së pagës, vlera e kontestit: 21279 euro, jashtë seancës, me dt.21.03.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve:Sh.S., dhe Th. B. që të dyja nga P., e parashtruar kundër të paditurës, Universiteti ‘H.Z.’ në P., me të cilën ka kërkuar që të: APROVOHET kërkesëpadia e paditësve:Sh.S., dhe Th. B. që të dyja nga P., si e bazuar ashtu që: DETYROHET e paditura Universiteti ‘H.Z.’ që PaditësesSh.S. t’ia paguaj në emër të kompensimit të diferencës në pagë për shkak të kualifikimit për periudhën 01.01.2020 për secilin muaj veç e veç nga 216.03 euro, e deri me datën 21.01.2023, për 37 muaj dhe atë me diplomë universitare të ciklit të dytë (magjistraturë), në vlerë prej 35 % nga paga bazë, shumën prej 7,993.11 euro (37 muaj x 216.03 € diferencë për çdo muaj = 7,993.11 €), 2. Paditëses Th. B. t’ia paguaj në emër të kompensimit të diferencës në pagë për shkak të kualifikimit për periudhën 01.01.2020 për secilin muaj veç e veç nga 359.1 euro, e deri me datën 21.01.2023, për 37 muaj dhe atë me diplomë universitare të ciklit të dytë (magjistraturë dhe doktoratë), në vlerë prej 35 % nga paga bazë, shumën prej 13,286 euro (37 muaj x 359.1 € diferencë për çdo muaj = 13,286 €),e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e ushtrimit të padisë, në afat prej 7 ditësh, nën kërcenim të përmbartimit me dhunë si dhe DETYROHET e paditura, që paditësve, t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë për padi 312.00 €, për seancë 405.60

€ sipas numrit tarifor 6 dhe 7 të TOAK-së si dhe taksën gjyqësore për padi 21.00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcenim të përmbartimit të detyrueshëm

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve, në këtë gjykatë ka ushtruar padi me datë 09.02.2024, kundër të paditurës Universiteti Publik „H.Z.” në P., me baze juridike: kompensim të diferencës së pagës për shkak të kualifikimit, më të cilën ka potencuar se Paditëset janë të punësuar si profesor tek Universitetin ”H.Z.” P., respektivisht kanë lidhur kontrata pune në afat të caktuar me të paditurën - Universitetin "H.Z." në P., dhe përmes kësaj padije ka theksuar se me hyrjen në fuqi me datën 06.02.2023 të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paditëset nuk janë kompensuar fare për shtesën në emer të kualifikimit, ashtu siç parashihet me vendimin nr.01/33 të datës 29.08.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, pasi që me nenin 45 par.2 të këtij ligji parashihej se “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategori tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerrë nga dispozitat e këtij ligji”. Bazën ligjore e mbështesim në nenin 245 par. I të LMD-së thuhet; 'Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtën që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij’., tani paditësit i takon shtesa në emer të kualifikimit siç përcaktohet andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditësve t’ia paguajë shtesat në emer të kualifikimit në lartësi prej 35% të pagës bazë, dhe atë për paditësen Sh.S., pagës bazë 772.50 €, respektivisht shtesën në shumën 216.03 € në muaj dhe atë duke filluar nga data 01.02.2023 e deri më datën 21.01.2023, respektivisht për 37 muaj t’ia paguaj shumën prej 7,993.11 (772.50€ paga bazë x 35 % = 216.03€ x 37 muaj = 7,993.11 €). Paditësen Th. B. pagës bazë 1,026 €, respektivisht shtesën në shumën 359.1 € në muaj, dhe atë duke filluar nga data 01.02.2023 e deri më datën 21.01.2023 respektivisht për 37 muaj t’ia paguaj shumën prej 13.286.7€, (1,026 € paga bazë x 35 % = 359.01 € x 37 muaj = 13.286.7 €) apo në total t’ia paguaj shumën prej 21.279 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak, ka proceduar tek e paditura aktvendimin C.nr.422/24 të datës 05.11.2024, për dhënien e përgjigjes në padi se bashku me prova, dhe në përgjigje në padi e paditura nder të tjera ka parashtruar se padinë dhe kërkesën e saj e kundërshtojmë, bazuar në argumentet ligjore dhe faktike sipas vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është e përcaktuar qartë se rritja e pagave bazuar në licencim dhe kualifikim është e aplikueshme vetëm për personelin mësimdhënës, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në institucionet e arsimit fillore dhe të mesëm në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtij vendimi diferencimi i pagës mbi kualifikim është ekskluzivisht për stafin e këtyre niveleve arsimore dhe jo për stafin e institucioneve të arsimit të lartë, përfshirë universitetet . Për më tepër në universitet avancimi akademik është i rregulluar me ligj dh akte përkatëse për arsim të lartë, ku rritja e pagës ndodh automatikisht me avancimin në thirrjen akademike siç parashihet për profesorët asistentë, të asociuar dhe profesorët të rregullt, andaj kërkojmë nga gjykata që kërkesat për diferencimin e pagës për shkak të kualifikimit të mos zbatohet në mënyrën e gabuar ndaj stafit akademik të universitetit, duke marrë në konsiderata faktin që ritja e pagës për këtë kategori realizohet vetëm përmes avancimit akademik. Sipas Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve kërkesat për kompensimin financiar jan subjekt i parashkrimit. Afati i parashkrimit për të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës është 3 vite nga data kur pala e dëmtuar ka pasur dienin për të drejtën e saj. Prandaj, bazuar në faktet e lartcekura të cilat argumentohen i propozojmë Gjykatës Themelore në P.-Departamenti i Përgjithshëm, që, pas shqyrtimit të padisë dhe provave të bashkangjitura, të veprojë në bazë të LPK-së, të nxjerrë vendim meritor me të cilin e refuzon tërësisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve të lartcekur si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e PA BAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, pas pranimit të përgjigjes në padi, duke u nisur nga fakti se, e drejta apo detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është e karakterit absolut, dhe në rrethana të caktuara mund të mos kërkohet mbajtja e një seance publike gjyqësore. Lidhur me këtë aspekt të procedurës, GJEDNJ në rastin *Jussila v. Finland* (Aktgjykimi i dt. 23 nëntor 2006, paragrafi 41), ka përcaktuar se, “*Detyrimi për mbajtjen e seancës gjyqësore publike nuk është absolut. Pra, ekzistojnë rrethana që nuk kërkojnë mbajtjen e një seance gjyqësore publike, dhe atë p.sh., kur nuk ka çështje të besueshmërisë ose fakte të kontestuara mes palëve dhe që determinojnë mbajtjen e një seance gjyqësore, andaj, gjykata mund të vendos në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme lidhur me çështjen në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve tjera të shkruara.*” Gjykata duke marr parasysh këtë, vendosjen në këtë mënyrë e bazoj duke i nisur nga natyra jo komplekse e çështjes në ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes paditëses Sh.S. dhe të paditurës nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës me numër 2398 e datës 03.10.2018, si dhe kontratës së punës me numër 2548 e datës 30.09.2021 të dy kontratat të lidhur në mes paditëses dhe të paditurës. Nga diploma Universitare e datës 10.07.2014 me numër 529, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, gjykata e vërtetoi faktin se paditësja ka të përfunduar Fakultetin e Ekonomik, dhe ka marrë titullin “*Master për Banka Financa dhe Kontabilitet*”. Nga lista e pagave e bashkangjitur në shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja realizon pagë bazë të rregullt mujore sipas listës së pagave, nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja Th. B. është në marrëdhënie pune tek e paditura sipas kontratës së punës me numër protokollit 2021 e datës 10.10.2016, kontrata me numër 1804 e datës 01.10.2020 si dhe ankesë kontrata me numër të protokollit 1627 datës 07.07.2021, të dy kontratat të lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës. Nga diploma Universitare e datës 24.03.2016, e lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore- Tetovë, gjykata e vërtetoi faktin se paditësja ka marrë titullin “*Doktor i Shkencave Ekonomike*”. Nga lista e

pagave e bashkangjitur ne shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi realizon pagë bazë të rregullt mujore sipas listës së pagave, nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Fakt vendimtar për t'u vërtetuar në këtë çështje kontestimore ishte nëse paditësve iu takon kompensimi i pretenduar në emër të kualifikimit.

Gjykata gjen se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33 të datës 29.08.2008 në pikën 1 është përcaktuar se *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Tutje, ky vendim në pikën 2 ka përcaktuar se *“Nga 1 shtatori 2008, përmes licencimit zëvendësohet sistemi linear i pagave përmes dallimeve pozitive të pagave për të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm.”*

Gjykata konstaton se Vendimi i Qeverisë me numër 01/33 i datës 29.08.2008, në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të arsimit parauniversitar (mësimdhënësve, drejtorëve (zëvendësdrejtorëve) dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat e Republikës së Kosovës në nivelin fillor dhe atë të mesëm), e që në rastin konkret paditësit janë të punësuar në arsimin universitar, përkatësisht në Universitetin ‘H.Z.’, e sipas vendimit të lartcekur, të njëjtëve nuk iu takon kualifikimi, andaj gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditësve.

Po ashtu gjykata ka marrë në konsideratë edhe deklaratimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, mirëpo për të njëjtën gjykata nuk është lëshuar në vlerësim pasi që paditësve nuk iu ka rezultuar themelësia e kërkesëpadisë, respektivisht e njëjta nuk ka bazë ligjore për t'u aprovuar, e pastaj gjykata të marrë në konsideratë prapësimin e të paditurës për parashkrim dhe ta vlerësoj periudhën e parashkrimit, në rastin konkret a kishte parashkrim apo nuk kishte.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Andaj, për arsyet e dhëna në këtë aktgjykim, pasi që gjykata ka konstatuar se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së që përcakton se “*Secila palë paraprkisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, e lidhur me nenin 463.1 që përcakton se “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin, 143.1 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE P.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:046795, C.nr.422/24, **26.03.2025**

Gj y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.